



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1016/7 Prot.

Patos, më 08 / 05 / 2026

Lënda: Rezultatet e konsultimeve publike të Bashkisë Patos.

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Patos.

Përmbledhje e rekomandimeve të konsultimit publik.

Dëgjese publike me temë: Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027 dhe 2029”.

Grupet që u konsultuan: Banorë të qytetit, të rinj të qytetit, banorë të Njesisë Administrative Ruzhdie, banorë të Njesisë Administrative Zharrëz, kryetarë të fshatrave, subjekte të qytetit, grupe interesi, anëtarë të këshillit bashkiak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Financës, dhe specialist të tjerë të administratës.

Këshilli i Bashkisë së bashku me ekzekutivin kanë realizuar takimin konsultativ në Njësine Administrative Zharrëz, Patos dhe Ruzhdie me banorë të qytetit, të rinj të qytetit, banorë të Njesisë Administrative Ruzhdie, banorë të Njesisë Administrative Zharrëz, kryetarë të fshatrave, subjekte të qytetit, grupe interesi, anëtarë të këshillit bashkiak, të cilët kanë dhënë opinonet e tyre në lidhje me kërkesat .

Këshilli i Bashkisë pasi analizoi rezultatin e dëgjesës publike vëren se kërkesat e banorëve janë:

1. Për qytetin janë realizuar dy dëgjesa publike përkatësish:

Për të rinjtë:

- Pajisja me foni zeri për shkollat
- Kërkesë për qëndër rinore në qytet
- Kende sportive

- Internet nëpër shkolla
- Bazë materiale për teatër për vënien në punë të klubeve teatrale
- Punimet për mirëmbajtjen e shkollave të shikohen me imtësi
- Pajisja me stola
- Lyerje e kangjellave rrethuese dhe prerja e pemëve në shkollën “Muhamet Shehu”
- Oborri i kopshtit në Oficinë të ndahet në dy pjesë për ndarjen e grupeve të fëmijëve si dhe të pajisjet me një minikënd të vogël.
- Pastrimi i Kopshtit të Grizës nga bari.

Për qytetin Patos:

- Investimet të përqëndrohen në infrastrukturën rrugore, bujqësore dhe KUZ.
- Rikonstruksion dhe zgjerim në rrugën e qendrës së qytetit.
- Të investohet për shtrimin e rrugëve të parcelave dhe rrugët e brendshme.
- Të investohet për përmirësimin e sistemit të ndriçimit rrugor.
- Shatervani i qytetit të vendoset në funksion.
- Shtrim 10 m² asfalt në lagjen e Re Vreshti, pjesa fundore e rrugës Vreshti, dhe problematikë një pusetë.
- Rikonstruksion banese.
- Ndërtimi i një tregu ushqimor në qytet.
- Paisja me kosha mbeturinash në lagjen Kripallarët.
- Mungesa e parkimit publik.
- Investimet të përqëndrohen nga bashkia deri në Rrugën “Mustafa Matohiti” dhe rruga që fillon nga Patos Lart deri në Oficinë.
- Ndërhhyrje në varrezat Hoxhallarë.

Njësia Administrative Zharrëz:

- Investimet të përqëndrohen në infrastrukturën rrugore, bujqësore, dhe ujësjellës.
- Të investohet për shtrimin e rrugëve e parcelave.
- Të investohet për sistemin e KUZ.
- Qendra shëndetësore të jetë funksionale.
- Pastrim i varrezave.
- Pastrim i kanaleve, rrugëve dhe kopshtit.
- Investim në zonën e Zabijes.
- Paisja me kosha mbeturinash në lagjen e Çobanëve.
- Duhet të ndërhyrë në urën.
- Ndriçim në rrugën “Halit Gjeriti”, shtrim dhe pastrim.
- Shtrimi i rrugës “Xhoraj”.
- Shtrimi i rrugës në Zharrës te Ngjeliu.
- Investim në rrugën “Ferraj” dhe ndriçim.

- Të investohet për shtrimin e rrugëve në parcelën nr. 105 Koroveshajt.
- Krijimi i një ambjenti për të moshuarit.
- Pastrimi i përroit të Zharrëzës.

Njësia Administrative Ruzhdie:

- Investimet të përqëndrohen në infrastrukturën rrugore, bujqësore.
- Ujësellsi.
- Të investohet për shtrimin e rrugëve e parcelave.
- Rrë bituminoze dhe çakull për rrugët.
- Pastrimi i fushës së sportit.
- Paisja me kosha mbeturinash.
- Ndriçim.

Bashkëlidhur procesverbali nr. 1016/3 prot., datë 21.04.2026, nr. 1016/4 prot., datë 22.04.2026, nr. 1016/5 prot., datë 24.04.2026, nr. 1016/6 prot., datë 27.04.2026.

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj



SEKRETAR

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj

